



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**6 nëntor 2017, Prishtinë,
Ref:21.09.2017\570-2017**

**Opinion i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Devolli Group kundër Kosovës Sot**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31 tetor 2017, shqyrtoi ankesën e Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot lidhur me artikullin "A do t'u heqë Haradinaj monopolet Devollëve të inkriminuar?!" të datë 13.09.2017, dhe nxori këtë

O P I N I O N

- Ankesa miratohet

A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se në këtë shkrim "analistët dyshojnë se Devollët ia kanë mbyllur gojën si partive politike në pushtet, ashtu edhe opozitë".

Bordi i KMSHK-se, pasi shqyrtoi artikullin dhe ankesën, kurse mungoi përgjigja e Kosovës Sot, konstatoi se në artikull mungojnë fakte të nevojshme të cilat do t'i mbështetnin këto supozime të analistëve.

Andaj, u vendos se bëhet fjalë për shkleje të Kreut II (Raportimi i së vërtetës). Gjithashtu, gazeta Kosova Sot nuk i ka mundur palës tjetër të prononcohet për çëshjtet të cilat shqyrtohen në këtë artikull, me çka ka shkelur Kreun IV (E drejta për t'u përgjigjur).

Opinionin u nxor me shumicën e votateve të të gjithë të pranishmëve.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMSHK vendosi si në dispozitiv të këtij opinionin.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës